



## MUNDËSI PËR TRAJNIME ONLINE NË KURSIN VEROR PËR DREJTËSI PENALE

Akademia e Drejtësisë, në bashkëpunim me ERA (**Academy of European Law**), dëshirojnë të ofrojnë vende pa pagesë për pjesëmarrje në Kursin Veror Online për Drejtësinë Penale Evropiane që do të mbahet në datat **26-30 qershor 2023**.

Për informacionin tuaj, në linkun e mëposhtëm do të gjeni web-faqen për ngjarjen në fjalë – së bashku me versionin e fundit të programit.

[https://www.era.int/cgi-bin/cms?\\_SID=12851c2efd2880736b1f7c7576e9ac122c35e8c300934085415281&\\_sprache=en&\\_bereich=artikel&\\_aktion=detail&idartikel=131763](https://www.era.int/cgi-bin/cms?_SID=12851c2efd2880736b1f7c7576e9ac122c35e8c300934085415281&_sprache=en&_bereich=artikel&_aktion=detail&idartikel=131763)

Në përputhje me përbërjen e delegacioneve në Trier, vendet pa pagesë do të ofrohen si më poshtë:

- 5 vende për gjyqtarë/prokurorë të përzgjedhur nga Shkolla e Magjistraturës së Shqipërisë
- 5 vende për gjyqtarë/prokurorë që do të përzgjidhen nga Qendra për Trajnim Gjyqësor dhe Prokurorial të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës
- 5 vende për gjyqtarë/prokurorë që do të zgjidhen nga Institucioni Publik Qendra për Trajnim Gjyqësor dhe Prokurorial të Republikës Srpska
- **5 vende për gjyqtarë/prokurorë të përzgjedhur nga Akademia e Drejtësisë së Kosovës**
- 5 vende për gjyqtarë/prokurorë që do të përzgjidhen nga Qendra për Trajnim në Gjyqësor dhe Prokurorinë e Shtetit të Malit të Zi
- 5 vende për gjyqtarë/prokurorë të përzgjedhur nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publik të Maqedonisë së Veriut
- 5 vende për gjyqtarë/prokurorë të përzgjedhur nga Akademia Gjyqësore e Serbisë

Afati i fundit për regjistrim është më së voni deri më **22 qershor**.

Për çdo paqartësi apo pyetje në lidhje me ngjarjen në qershor, ju lutemi komunikoni me zyrtaren e ERA Anna Andres [ALees@era.int](mailto:ALees@era.int)